

TEFTA MUSTA
FALEMINDERIT TY
TREGIME

BOTIMET TOENA

TEFTA MUSTA

FALEMINDERIT TY

tregime

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-53-4

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Edhe ndodh

Kur e dëgjoja të shprehur nga të tjerët, nuk e besoja kurrë, se edhe unë do të bëja pjesë në grupin e atyre njerëzve që nuk duan ato që kanë. Punuaka dhe sakrifikuaka njeriu njëzet vitet e reja të jetës për t'i humbur të gjitha, të themi në një natë, apo në disa sekonda, varet sa i zgjat orgazma.

Ajo që ndodhi më gjeti familjar të rregullt, me dy fëmijë adoleshentë, me grua që fizikisht dhe shpirtërisht ishte gjithçkaja ime. Më mjaftonte gjithçkaja, i gëzohesha gjithçkasë, i jepesha me shpirt asaj dhe tani e kuptoj që lumturia është thjesht përditshmëria jonë. Por, ndonjëherë, ardhka çasti, kur fati i keq të trondit.

Pas një aksidenti gruas sime iu desh një kohë e gjatë përkuajdesjeje. I gjithë fisi na u gjend pranë me ndihma të ndryshme. Prindërit e saj morën fëmijët përkohësisht, vëllai im i shoqëronte për në shkollë e, në një farë mënyre, iu përshtatëm nevojave të reja. Kuptohet që i shërbeja gruas sime me shumë dashuri, besomëni, por duhej të punoja. Kështu motra e saj lejoi që vajza e vet të qëndronte

me ne ato kohë. Pothuajse e kisha rritur atë fëmijë, çdo vit e kishte bërë plazhin me ne, ishte dy vjet më e madhe se djali ynë i madh. Vitet e fundit jetonte me familjen në Greqi dhe, gruaja më pati treguar, se të gjithë shqetësoheshin për të. Ndërsa unë mendoja, se mbi të shkarkohej pafuqia që sillte përplasja e mendësisë shqiptare të prindërve të saj me liberalizmin e jetës greke dhe isha i bindur se ajo thjesht donte të kishte të gjitha të mirat shpejt, ta jetonte rininë ashtu siç e imagjinonte, ashtu siç mendonte se i takonte dhe, fundja, si të gjithë të rinjtë e botës: me shumë liri e me pak përgjegjësi.

Kështu, kaloi adoleshencën mes gëzimesh e zhgënjimesh të moshës. Kurrë nuk do ta di se cili qe çasti magjik apo tragjik, kur unë ndjeva, se heroi i saj do të isha unë. Kur e kuptova këtë, u ngrita nga divani, hapa dritaren dhe, duke parë jashtë, me shpirtin që më shkrihej i tëri, u ndjeva krenar që do ta arrija këtë. M'u duk vetja shpëtimtari i një jete. Unë kisha gjithçka: ekonominë, pjekurinë dhe moshën, nuk më shkoj fare ndër mend që isha gati si babai i saj. Nuk mund të më qortoni se nuk e pyeta ndërgjegjen për faktin që ishte mbesa e sime shoqeje. E pyeta, ju betohem, por ajo nuk m'u përgjigj. Edhe ndodh.

I dhashë makinën e sime shoqeje për në shkollë, i dhashë lirinë ekonomike dhe atë për të dalë me shokë e shoqe, pasi mendoja se s'mund t'i kalonte të gjitha pasditet duke u kujdesur për gruan time. Dhe ndihesha mirë, ndihesha i mirë dhe e besoja rolin tim si shpëtimtar. Ishte e qartë që pasioni as që më linte vend për të menduar. Kuptohet, të dashuroja

në moshën dyzetvjeçare një tetëmbëdhjetëvjeçare, ishte një mrekulli. Ndihesha i ri, i mundja me një goditje sëmundjet që nisën të trokisinin, thinjat, barkun e kërcyer paksa, mundja kohën, rregullat, më vinte t’i ulërija botës se vleja ende, se jepja ende dashuri, se mund të bëja ende dikë të lumtur, të krijoja familje, të lindja fëmijë. Nuk kishte rëndësi kush ishte vajza, rëndësi kishte drithërima e trupit që më kapte sa herë ajo vonohej, sa herë ajo rrinte me një djalë, sa herë ajo rrinte ftohtë. Dhe atëherë, nuk e di pse harroja fare se kush isha, hiqja maskën e burrit të mirë, s’më bënte më përshtypje gruaja që shihte e heshtur dhe, më në fund, e braktisa atë ende të pashëruar, duke qenë i bindur se isha njeri i veçantë, i bekuar nga Zoti, me plot dashuri në vetvete, i aftë të bëja edhe një familje të dytë të lumtur.

Shtëpi e re, universitet, pushime, dashuri, pasion. Sërish më mjaftonte gjithçka. Por (pse ekziston kjo lidhëz dreqi?!) qyteti për të dashurën time zgjerohej, miqësi të reja, vonesa të reja, shokë të rinj, shije të reja, pakënaqësi të reja, grindjet e para, pajtimet e para, sherret e dyta, faljet e dyta, tradhtia e saj - shndërrimi im në qesharak, arratisja me të dashurin - rrënimi im. Kaq. Mjaftuan tetë muaj që heroizmi im të mbyllej me togfjalëshin “Plakaruq i shpifur!”. Nuk di të them në e bëra më të shthurur, apo në u bëra unë vetë më i shthurur. Më besoni, i di pyetjet që ju vijnë në mendje tani, i di moralet, i di sharjet dhe mallkimet, por nuk di përgjigjet, të paktën të njërës pyetje: Çfarë fuqie ka pasioni te njeriu?

Do të kisha vuajtur gjatë nën zinxhirët e xhelozisë, të inatit të braktisjes, të armiqësisë me fisin tim dhe të ish-

gruas sime, por sidomos të deheroizmit tim, sikur një ditë të afërt motra ime e vogël të mos kishte ardhur, duke më ulëritur, duke më sharë e mallkuar e duke më vërvitur çantën mbi kokë. Gjëra tualeti, abone, telefon, lekë u shpërndanë si mundën rrotull meje. Mes lebetitjes së dëshpëruar, më tha se i shoqi e kishte lënë me dy fëmijët e vegjël dhe kishte shkuar të jetonte me ish-gruan time, të shëruar tashmë. Nuk m'u hap toka nën këmbë, nuk m'u morën mendtë, vetëm një shqyerje e zemrës e pandier kurrë më parë më shembi përtokë. Me shpirt fillova të qesh fort, fort, derisa mbeta pa frymë, me gojën hapur, ndërsa lotët më rrëshqisnin ngjitur me veshët.

Hakmarrja e një femre të zgjuar s'do të ishte kurrë kaq e përsosur. Tani e tutje, barazia gjinore nuk kishte pse të ishte më kauzë utopike. Kisha harruar që dikur, njëzet vjet më parë, e kisha dashuruar pikërisht për këtë: sepse ishte e bukur, por (dreq!) e zgjuar.

Nuk do ta kení parajsën

- Ndonjë natë këta të mallkuar do të më shuajnë, - tha Karonti teksa kërkonte në errësirë kapotën që e linte gjithnjë në fund të varkës. U ngrit mbi hijet e këmbëve hollake e qerose dhe u mat të ecte drejt kapotës, por varka u lëkund dhe plaku ra në anë të saj duke mbajtur brinjët me dorë.

- Të mallkuar, të mallkuar, të mallkuar, - ulërinte plaku duke shtrydhur copat e grisura të fanellës që iu lag nga uji i zi e i trashë që rrëshqiti në varkë. - Si s'më latë një çast të çlodhem?! Më bluat fare, të mallkuar! Rrini aty, prisni radhën po ju them, - thërriste dhe zgavrat të zmadhuara nga dobësimi e tërbimi ishin e vetmja gjë e zjarrtë që grupi në breg të lumit shikonte të vinte drejt tij nga bota e përtejme.

Plaku pa se atje po bëhej luftë. Pesë hije lëviznin, zvarriteshin, rrokulliseshin, binin e hipnin mbi njëra-tjetrën, tërhiqnin këmbë, krahë, kokë, ulërinin, gërthitnin e kacafyteshin. Në njërën anë, që ishte thuajse e errët, ai mezi shqoi shpendin e zi të Ferrit, që zhvaste me tërbim dy shpirtrat e dy trupave të vdekur e të shtrirë buzë lumit, kurse

në anën tjetër shqoi menjëherë shpendin e bardhë të Parajsës dhe një krijesë tjetër, që përpiqeshin të mbronin shpirtrat e atyre dy të vdekurve. Ishte hera e parë që ndodhte kështu. Ai lëvizte lopatat me ritmin e rregullt shekullor dhe valët që linte varka çuditërisht ishin të buta. Askush s’e dëgjonte zhurmën e tyre. Ishte qetësi e rëndë. Vetëm sharjet e kithëta të plakut tregonin se ai po afrohej.

- Mëkatarë të fëlliqur. Si s’u lodhët duke mëkatuar! Mos shtyni, mos shtyni po ju them! - ulëriti zëçjerrë prej lodhjes.
- Ti, ti, futu në radhë ose na, - dhe e goditi fort njërin që u shkëput nga grupi i luftëtarëve.

Shpirti i mjerë klithi nga dhimbja dhe, zëri jehoi thellë, u përplas diku në gropë dhe u kthye i tjetërsuar. Plakut i ra lopata nga dora. Nga goja e hapur jargët iu varën mbi mjekrën e bardhë, duke i shkarë drejt barkut të thatë. Nuk ishte zë i zakonshëm për Ferrin, jo i panjohur për Karontin.

- Je kthyer prapë? - pyeti në terr plaku duke u dridhur i tëri. - Përse?

Krijesa bëri një hap para dhe plaku vërejti syshqyer pamjen e saj. Ishte e njëjta. Krijesa ishte e njohur. Plakut i kujtohej mirë që nuk quhej shpirt.

Dikur, shekuj më parë, kur si varkëtar i ri në Ferr punonte me lehtësinë dhe fuqinë që të jep fillimi, kjo krijesë e tronditi Ferrin me ato që pa e tha për të dhe, sonde, kur Karonti ishte stërlodhur dhe krahët i ishin bërë lopata të gjata sa shekujt e tij në Ferr e shpresonte se aty ku vendosej drejtësia do ta lexonin dosjen e tij, për të dalë në një lloj pensioni, skena u përsërit.

Dëshmitar i shekujve mëkatarë, Karonti s'e kuptonte pse kjo krijesë kërkonte të shikonte sërish Ferrin.

- Nuk dua të kaloj matanë, - sqaroi krijesa duke parë Karontin në sy. - Dua të shpëtoj këta të dy, - dhe tregoi dy qenie të ngjashme me të, por të shqyera, të shtypura e të gjakosura jo sikur po hynin, por sikur sapo kishin dalë nga Ferri.

- Përse? - pyeti plaku me dëshpërim.

- Sepse njeriu ka ndryshuar që kur i tregova se ç'e priste këtu, - tha ai i bindur.

- Ah! - psherëtiu plaku me vete, i kënaqur që të paktën Ferri nuk ia kishte bluar tërë kujtesën, ashtu siç kishte bërë me shumicën e ndjesive, - kështu quhet kjo krijesë: njeri.

Njeriu donte të fliste akoma mbi vetëdijen njerëzore. Në buzën e kundërt të Akerontit shtyheshin shpirtra gjithëformësh e gjithëngjyrësh, të azdisur nga zëri që kishte zgjuar instinktin e thellë e të vjetër: atë të llojit. Kishin lënë zgavrat, llucat, akujt, llavat e zjarrit; kishin kapërcyer gremina e roja të llahtarshme dhe tani shqyheshin e shtypeshin palë-palë në buzë të lumit të zi. Klithmat dhe zërat e tyre të shkrira bashkë nuk kishin asnjë emër. Ferri dridhej. Pesha e gjithë mëkateve ishte mbledhur në një pikë, atje, në buzë të Akerontit.

- E shikon? - tha plaku i tërbuar. - Prania jote shungullon jetën tonë, prandaj m'i jep ata të dy dhe mbathja.

- Nuk mundem, - tha njeriu. - Unë mendoj se nuk janë për këtu, pavarësisht se ç'thotë roja juaj.

- Unë nuk punoj kot, dhe aq më pak me mendjen time, - dhe nga cepi i portës së gjerë të Ferrit fluturoi drejt tyre një zog i stërmadh, me pupla të zeza e sy të kuq.

- Sa shumë u përpoqe! Ke shekuj që e bën, - shtoi plaku duke e parë njeriun me një bezdi të dukshme.

Njeriu u mat të fliste, por...

- Nga atje ku vendoset drejtësia na dërguan në punë dhe ne e bëjmë punën mirë, - krrokati shpendi i zi. - M'ï jep menjëherë! - urdhëroi dhe u përkul drejt dy hijeve të përgjakura shtrirë të pajeta te këmbët e njeriut.

- Unë nuk mendoj se keni të drejtë, ndaj kërkoj më parë një gjykim, - iu përgjigj prerë njeriu duke i dalë para.

- Mirë! Shkojmë në gjyq. Fundja dihet se te Minosi do të përfundojnë edhe këta, - dhe shpendi sykuq i pa tërë përbuzje të tre.

Parandjenja e plakut po vërtetohej. Skandalet po nisnin edhe në Ferr. Ai mendoi se Minosi, gjyqtari i besuar i Ferrit, duhej të ishte i pranishëm, ndaj voziti sa më shpejt dhe e solli pranë tyre. Minosi hungëriti. Ata të gjithë i bënë vend bishtit të tij të gjatë. Karonti la lopatat në gatishmëri, vuri bërrylat e rrudhosur mbi kockat e kofshëve, mbështeti kockat e mëdha të faqeve mbi duart plot kallo, që i gërvishtën vende-vende lëkurën e rrudhur e të zgjatur të faqeve.

Njeriu, engjëlli i plotfuqishëm trupzi i Ferrit dhe engjëlli i plotfuqishëm pendëbardhë i Parajsës, i vendosën dy kufomat në mes. Pak më anash qëndronte kërcënueshëm Minosi. Mbas krahëve të plakut shtrihej i gjithë Ferri dhe, në thumbin sterrë të tij, ai shqoi tri gojët e përgjakura të Djallit që ngërdhesheshin. Karonti zgjati kokën para drejt dy të vdekurve. Me sy gjysmë të mbyllur nga lllapat e kapakëve të rrudhur nga gjithçka ferrësore, pa një burrë në

moshë të pjekur dhe fustanin e kuq të një vajze. Errësira e paraferrit nuk e lejoi të kuptonte nëse e kuqja ishte ngjyra e fustanit, apo fustani ishte kuqur nga gjaku i saj.

- E nderuara Drejtësi! - filloi njeriu duke parë nga Qielli përmes portës ende të hapur. - Guxova e hyra deri te porta e Ferrit sonte që të të kërkoj të mos dërgosh në rrathët e tij dy njerëzit e mi, të cilët vdekja i mori në një aksident. Ishin njerëz të mirë që i zbatonin të gjitha detyrimet e të drejtat e jetës në Tokë: kishin familje, miq, punë, jetë shoqërore, dashuri dhe, këtë të fundit, dua ta theksoj.

- Nëse është kështu, s'kuptoj pse i plotfuqishmi i Ferrit kërkon që ta kalojnë lumin e tij, - u përgjigj qetë Qielli.

- Nuk është tamam kështu, i nderuar, - foli me zë të fortë i plotfuqishmi i Ferrit. - Njeriu foli bukur, sepse kjo është detyra e tij: të justifikojë çdo gjë që bën lloji i tij. Detyra ime, që edhe mua ma keni caktuar Ju, është të ndëshkoj të gabuarën, të keqen, mëkatin. Dhe këta të dy janë mëkatarë, sepse ishin dashnorë.

- Nuk ishin dashnorë, - ndërhyri rreptë i plotfuqishmi i Parajsës, - por të dashuruar dhe ky është një ndryshim i madh. E nderuara Drejtësi! Detyra që më keni caktuar është që të mbroj të bukurën e virtytin dhe dashuria është një virtyt i bukur.

- Është e vërtetë kjo që u tha, - plotësoi njeriu. - Në tokë jeta është e ndërlikuar, e çuditshme, disa veprime i bëjmë edhe pa u menduar shumë, ose ngaqë mendohemi shumë e, meqë shpesh s'dimë si t'ia bëjmë, zgjedhim të jemi të lumtur për aq pak kohë sa na lejohej.

- Jetën e bëjnë njerëzit dhe, nëse ju e keni të ndërlikuar, do të thotë se e keni bërë ju. Pra, do të thotë se dikush prej jush nuk e ka kryer në rregull detyrën ose të drejtën e tij, - akuzoi i plotfuqishmi i Ferrit.

- Ndjenja e dashurisë është dhurata më e bukur që i është bërë njeriut nga Krijuesi i tij dhe, të mos e pranosh atë, është mëkat. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë mbi të, ndryshe jeta s'do të ishte kaq e vlerë. Mund të rendis, e nderuara Drejtësi, mijëra shembuj për këtë, - shpjegoi njeriu.

- E pranoj logjikën tuaj, i nderuar koleg, më lejoni t'ju quaj kështu për shkak të pozicionit që kemi në këtë rast, - iu kthye i plotfuqishmi i Ferrit, - por mos harro se ndjenja e këtyre është ngritur mbi tradhtinë e dyfishtë: ky ka tradhtuar familjen dhe kjo ka tradhtuar llojin e saj, përderisa i ka rrëmbyer mashkullin një femre tjetër. Dhe kjo është shumë e rëndë.

- Nuk di ta them me siguri. Ndoshta kjo vajzë nuk e ka ditur që ky ishte i martuar, - foli njeriu me shpresë se mund të ishte e vërtetë.

- Përkundrazi, e ka ditur, ka pranuar dhe ka vazhduar të mëkatojë. Ky është veprim i ndërgjegjshëm, ndaj është i dënueshëm në çdo rrethanë, - replikoi ashpër tjetri.

- Çka provonin ata për njëri-tjetrin ishte e bukur, e ëmbël, jashtë çdolloj përcaktimi ligjor vërtet, por ama është natyrë njerëzore. Çka prodhonin shpirtrat e çka përjetonin trupat e tyre është ndjesia më e kulluar e njeriut; është ajo për të cilën ne jemi krijuar. Si mund të themi se kemi jetuar, nëse s'jemi drithëruar nga prekja e tjetrit, nëse s'jemi përplotur

nga puthja e tij, nëse s'jemi lëngëzuar nga shkrirja me të, nëse s'na ka munguar, aq sa bota plot të na duket bosh pa të? - foli me bindje njeriu.

- Si mund të thoni se keni jetuar kur, ndërsa ai përjeton këto, gruaja e tij drithërohet nga mungesa e tij, përletet nga malli për të, psherëtin fyerjen dhe braktisjen, ndihet e pavlerë dhe e përfolur? Si mund ta quash dashuri, kur kjo vajzë që, sipas teje e dashuron këtë burrë, lejon të jetë thjesht një përemër? A mund ta lejosh njeriun që do të ta bëjë këtë? Dhe për më keq, si mundet ky burrë që ditën të dashurojë, të shpenzojë, të dhurojë, të japë dashuri të çdolloj forme e në darkë të bëjë të njëjtën gjë edhe me gruan e tij? A më thua dot se ky burrë e ka dashuruar këtë vajzë? Thjesht fare: nëse do ta dashuronte, do të ishte i saj, - foli thatë engjëlli i Ferrit.

- Ne njerëzit jemi të brishtë.

- Fortësohuni! - i bërtiti në fytyrë engjëlli pendëkorb.

- E tyrja është një ndjenjë që u ka qëndruar viteve dhe kjo pohon vlerën e dashurisë, - ndërhyri engjëlli i Parajsës pa u trembur fare nga turfullima e engjëllit të Ferrit.

- I dashur koleg! Kemi qenë gjithmonë në luftë, për të fituar shpirtrat e këtyre, - ai shtriu krahun e zjarrtë drejt njeriut dhe kufomave, - besoj se e dimë mirë të dy që këtu nuk ka shpresë për ty. Kjo që thua ti mund të zgjaste edhe shumë më tepër, mbase edhe tërë jetën, përderisa të dyve u plotësoheshin interesat: ky plotësonte pasionet, po përdor një term tolerant në këtë rast, ndërsa kjo, krahas pasionit, plotësonte edhe interesat ekonomike.

- Dinjiteti njerëzor... - filloi njeriu.

- Lëre fare këtë çështje, - e ndërpreu ashpër i plotfuqishmi i Ferrit. - Në këto ky nuk hyn fare. Kjo vajzë nuk ka fare dinjitet, përderisa nuk respektoi veten, nuk ndërtoi status shoqëror, nuk krijoi familje, nuk la pasardhës, siç është edhe detyra juaj. Pranoi të ishte dashnorja ose ajo kurva, siç ju kam dëgjuar ju njerëzve t'i quani femrat në këto raste, - engjëlli i zi foli me përbuzje të dukshme.

- Këmbëngul se kjo nuk është mungesë dinjiteti, siç kërkon ta njollosni ju, por sakrificë për dashurinë, - zëri i engjëllit të Parajsës ishte i lartë, i sigurt dhe vërtet këmbëngulës.

- Sakrificë do të ishte nëse kjo do ishte larguar që në fillim, ose nëse ky do të ishte divorcuar për ta bërë këtë gruan e tij, zonjën e tij, perëndeshën e tij. Çfarë e pengonte ta bënte? - dhe engjëlli sykuq i Ferrit e pa njeriun ngultas në sy, a thua se atë çast ndahej gjykimi final. - Jo, pyetja e duhur s'është kjo, por pse duhej ta bënte, kur përfitonte, në mos i shfrytëzonte të dyja? - ironizoi duke e parë me një lloj triumfi njeriun.

- Ndjenja e tyre u qëndroi provave të forta, largësive, pritjeve, vështirësive gjithfarëshe dhe këtë s'mund ta mohoni, - kundërshtoi prerë njeriu.

- Nëse kishte një provë kjo lidhje, ajo ishte pyetja: A duhemi? Nuk duheshin, përderisa ky burrë nuk e deshi aq sa të martohej me të dhe as kjo vajzë s'e deshi aq sa t'i tregonte atij se vlente shumë më tepër se të qenët dashnore. Kaq! - tha prerë engjëlli i Ferrit. Pastaj, pasi u rrotullua vrullshëm mbi kufomat, u ul sërish përballë dhe shtoi:

- Ju njerëzit keni vënë rregulla, sepse keni nevojë për to, sepse nga to dalloni të mirën nga e keqja e, në to dalloni, dashurinë nga tradhtia, lidhjet martesore nga ato jashtëmartesore, fëmijët e ligjshëm nga ata të paligjshmit. Nëse doni ndryshe, ndryshoni rregullat, pasi me këto rregulla që keni, ne ju gjykojmë mëkatarë.

U duk sikur engjëlli i sygjaktë vulosi vendimin.

- Atëherë, sipas teje, njeriu duhet të mbetet rob i martesës, apo më saktë i detyrimeve më tepër se i ndjenjës? - pyeti ftohtë njeriu.

- I dashur koleg i rastësishëm! Ta thashë e po ta përsëris: ju keni vendosur të jetoni me rregulla dhe ndëshkimi vjen kur shkelen ato. Askush s'ka ndëshkuar dy të rinj që dashurohen, askush s'i ka quajtur mëkatarë, ndaj është detyra juaj të përjetoni, të kuptoni dhe të vendosni për ndjenjat tuaja në kohën dhe në mënyrën e duhur, - foli sërish thatë i gjakti.

- Unë ende besoj te ndjenja e tyre, e cila ishte aq e pastër dhe e fortë, sa edhe në vdekje ishin bashkë, - dhe engjëlli i bardhë i Parajsës bëri të njëjtën gjë: fluturoi mbi kufomat, ngadalë. U duk qartë prekja e lehtë e fytyrave të zverdhura.

- Ah, koleg, koleg! Nuk mund të ishte ndryshe, sepse mëkatarët janë bashkë gjatë mëkatit të tyre dhe, vdekja për ta, ishte ndëshkimi i fundit. Kjo mbeti “ajo” dhe ky mbeti “ai”, as emrin s'kanë më. E kupton? Në jetë humbën identitetin, para disa çastesh humbën trupin dhe tani do të humbasin edhe shpirtin. Thjesht do të shpërbëhen, - dhe i plotfuqishmi i Ferrit ngriti supet thumb.

Për një çast heshtja e plotë u dëgjua qartë. Ishte një fraksion çasti kur Ferri i përjetshëm nuk lëshoi zë. Siç dukej respektoi vendimin.

- Në rrethin e nëntë! - dhe zëri bubullues i Qiellit jehoi me shungullimën e goditjeve të Minosit. Goditjet inatçore të bishtit të tij e shkundën Ferrin nëntë herë rresht. Gërthitjet, klithmat e lemeria u përzien sërish dhe shpirtrat iu sulën rrathëve me potere. I zverdhur nga dhimbja e dështimit, i plotfuqishmi i Parajsës u pa disa çaste sy më sy me njeriun dhe, nga porta ende e hapur, fluturoi drejt Parajsës. I qetë, i plotfuqishmi i Ferrit vëzhgonte me kujdes saktësinë e Karontit, teksa duke rënkuar ngarkonte në varkën e brejtur dy shpirtrat e rinj.

Në buzë të lumit, njeriu, i vetëm e i dëshpëruar, shihte se si drita po zhdukej së bashku me shpirtrat. Instinktivisht zgjati dorën si për të ndalur varkën që po nisej. Karonti e pa dhe u drejtua nga ai. U lexuan ndër sy dhe me dashamirësi plaku i tha:

- Ai, - plaku ngriti gishtin drejt Qiellit, paralel me kokën qerose, - dikur të lejoi të shihje e të tregoje Ferrin, Purgatorin dhe Parajsën. Sonte të lejoi të hyje deri në buzë të lumit, që ndan botët e të dha mundësinë të bëje gjyq. Më beso, kjo është e pandodhura e Ferrit. Humbe, sepse ju njerëzit nuk e kujtoni Ferrin kur dëshironi Parajsën. Harroni që Parajsa dhe Ferri janë ekuilibrat tuaj. Po të them një sekret plaku, - dhe u zgjat pak, - kjo është hera e dytë që vjen në Ferr për të tjerët. Nëse vjen edhe një herë, s'do të ketë më kush të të tregojë për Parajsën. Dhe tani po i marr shpirtrat dhe po të lë trupat e tyre. Trupin deshën, trupin patën, kockat do të kenë. Varrosini, sepse vetëm këtë mund të bëni.

Ca gjëra duhet të mbeten mister

U ula në të vetmen tavolinë të lirë diku, në cep. Ngjante si e braktisur pasi nga ajo shihje vetëm dy pamje: banakun, po të uleshe përballë, dhe një rresht tavolinash, po të uleshe anash. Instinkti më uli anash. Vura çantën në karrigen bosh më afër, rregullova telefonin në të djathtën time, shtyva përtokë ca grimca sheqer nga tavolina dhe, pasi kontrollova kot telefonin, u mbështeta lehtë në shpinore. Më mbetej tashmë të shihja tutje rreshtin e tavolinave plot me njerëz. Në të tretën njoha një çift të dashuruarish.

Në fakt, secilin prej tyre e njihja nga bashkëshortët përkatës: gruaja e tij punonte mësuese në shkollën e sime motre, kurse burri i saj, inxhinier elektrik, kishte shtëpinë e prindërve në pallatin e ri të ngritur hata në krah të shtëpisë sime. Kisha dëgjuar shumë për ta, thashetheme apo të vërteta nuk di të them. Në fakt, asgjë s'më kishte bërë përshtypje, se gjithmonë kam pasur mendimin që punët e dashurisë realisht i dinë vetëm të dashuruarit. Zakonisht të dashuruarit, sidomos të martuar, janë shumë të kujdesshëm

në vetekspozimin me fjalë apo me sjellje, kështu që, ne të tjerët, atë që shohim, e perceptojmë si duam dhe atë që dëgjojmë, e tjerim sa të duam. Fundja, kur flasim ne, asnjë nga ata s'është i pranishëm, kështu që ne çlirojmë fantazitë tona pozitive e negative.

Ishte hera e parë që i shihja bashkë. Lokali nuk ishte shumë popullor. I vështrova. Ishin përballë njëri-tjetrit në profil me mua. Ishin të bukur ende. Flitej se, që në rini, kishin qenë të tillë. Ajo i kishte ende flokët me onde të kapur përgjysmë në majë të kokës dhe gjysma tjetër i ledhatoheshin në gushë e supe sa herë lëvizte drejt tij. Mosha e kishte detyruar të bënte fije, por pse jo?! Hunda e shkurtër tipike e vajzave të bukura ishte ende e ngritur pak lart. Nuk i shquaja dot në kishte apo jo rrudha te sytë, por më pëlqente kur qeshte. Edhe ai ishte i bukur. Dukej burrë i gjatë, i veshur me shumë shije dhe, megjithëse rrotullonte shpesh paketën, nuk ndezi cigare, të paktën për aq kohë sa i vëzhgova unë. Buzëqeshte shpesh dhe shumë rrallë shihte rrotull. Lehtë lexova se ishin zhytur te njeri-tjetri dhe më pëlqeu kjo. Nuk e shmanga dot t'i vështroja edhe disa herë, duke u munduar të kuptoj ndjesitë e tyre. Sa vite kishin të dashuruar? Kushedi! Si ndiheshin nën vështtrimet tona? Kushedi! Si i kishin punët në familje? Kushedi! Si arrinin t'i bënë të gjitha; punën, familjen, fëmijët, dashurinë? Kushedi!

Vazhdoja t'i mbërtheja e t'i zbërtheja me sytë e mendjen time derisa u lodha. Më shkonte turpazi thënia: Lodh kokën me hallet e botës! Buzëqesha. Fundja, po hiqja mendjen

nga hallet e mia. Pastaj befas më erdhi keq për ta. M'u dhimbsën. Çfarë kishin fituar deri tani? Një orë në prani të njëri-tjetrit, herë shpirtërisht e herë fizikisht. Ku do të shkonin më tej? Askund. Tani thuajse po bëheshin gjyshër dhe s'më besohej se do të bënin diçka ndryshe. Përfytyrova kotësinë e jetës së tyre në familje e në dashuri. Një familje pa dashuri, një dashuri pa kohë, pa vend, pa qetësi.

M'u duk se as unë nuk po i lija të qetë, kështu që shfrytëzoja mundësinë e dytë: pashë nga banaku. Një djalë i ri, pasi fshinte me kujdes me peshqir blu ngjyrëdalë fundet e filxhanëve dhe gotat e ujit, i vendoste gati me përkëdhelje në tabakanë që kamerieri, edhe ai djalë po aq i ri, saqë nuk i kishte hequr ende mustaqet fëmijërore, ia linte pa as më të voglën zhurmë në cep të banakut ngjyrëlejla. E keni vënë re edhe ju apo e teproj unë me mendimin se portreti i banakierëve kolopuçe dhe kameriereve elegante të dikurshme sot është zëvendësuar nga djem të rinj e të zellshëm? Nejse, e pranoj konkurrencën në çdo fushë.

Nga lloji i filxhanit që djaloshi banakier vendosi në tabakanë e radhës kuptova se nuk ishte çaji im, kështu që u shkëputa prej banakut dhe iu ktheva sërish pamjes tjetër. Po fliste ai. Ajo e dëgjonte me buzëqeshje. Pastaj foli ajo. Shkurt. Ndoshta ktheu përgjigje. Ai buzëqeshi në fund të fjalisë. E dini? Buzëqesha edhe unë. Jo ngaqë e qeshura është ngjitëse, por ngaqë pashë të humbisnin shpirtrat e tyre deri në harresë. Eh! Të dashuruarit janë fantastikë! Njerëz që vetëm buzëqeshin, që u duket e mrekullueshme çdo fjalë e thënë nga tjetri, që i eksiton aroma e mirë e trupit të ngrohtë, që i

përflak trup e shpirt çdo dritëz që bulon në sytë e tyre, që dëshirojnë aq shumë të preken, qoftë edhe duart, që...

- Zonjushë, çaji juaj.

U drodha. Filxhani me çaj të avullt, një detaj kaq i rëndomtë i realitetit, kishte bërë gjëmën. Ndjesia ishte sikur të më kishin ndërprerë në prag orgazme. Veçse ishte edhe më dërmuese: ishte orgazmë shpirtërore. Nga ato që pak njerëz i çojnë deri në fund. Eh! Si gjithmonë realiteti!

Fillova të ngjeroj detajin e rëndomtë të realitetit (në këtë emër të ri për çajin futa goxha mllef) dhe u përpoqa të rivendos lidhjen e këndshme me ta, por... Ata aty ishin, po njëlloj, veçse unë nuk i shihja më ashtu, apo më mirë nuk e ndieja më ndjenjën e tyre. Avujt e nxehtë të detajit të rëndomtë të realitetit tashmë nuk ishin kondensuar në ujë në stomak, por kishin ngrirë në shpirtin tim dhe këtë radhë u inatosa me ata të dy. Çfarë bisedonin vallë? Halle të familjeve? Arritje të fëmijëve? Dasmata e tyre? Ekonominë? Çështje pune? Gëzime familjare? Planifikime të udhëtimeve? Sëmundje? Sport? Libra? Se këto janë jeta, apo jo?! Apo flisnin për dashurinë? Për kë? Për njëritjetrin? Për bashkëshortët? A ua përmendin emrat atyre, apo i etiketojnë me “ai” e “ajo”? Apo flisnin për ta si për dy të afërm të zakonshëm? Si e kishin zërin? Sytë? Buzët, a u dridheshin? Faqet, a u skuqeshin? A u thahej goja kur flisnin për ta, apo ata s’ishin asgjë, nuk i emociononin me asgjë e për asgjë. Po “ai” e “ajo”, e dinin vallë? Atëherë pse kishin ndenjur, e më keq, pse vazhdonin të rrinin ende me ta? Ç’ishte kjo gënjeshtër e madhe që kishte kaluar jeta e tyre?

Ne të rinjtë vërtet ndoshta s'e dimë ç'është dashuria e vetme, e madhe, por ama ato të voglat, për aq sa zgjasin, i kemi të gjitha për vete. Ndoshta na zgjasin pak, sepse nuk bëjmë, dhe unë personalisht mendoj se s'kemi pse, kompromise të tilla: kur ajo, ai ose unë duam dikë tjetër, ndahemi.

O dreq! Rashë në moralizim. Harrova fare që dashuria në fakt është të gjitha këto, por, për dreq, s'pyet fare për asnjë nga këto.

Dashuria sheh vetëm siluetën e atij/e asaj që pret, dëgjon vetëm zërin e tij/e saj që e fton, mendon vetëm çastet kur kridhen në sytë ose trupat e njëri-tjetrit dhe shkrihen, të lodhur nga e ndaluara shijojnë nevojën për njëri-tjetrin, ushqehen me tretjen e mallit, qullosen shpirt e trup në atë symbyllje kapitëse, rënkojnë nën torturën e pritjes, që s'e dallojnë dot: të asaj që kaloi, apo asaj që do të vijë, deri herën tjetër... deri herën tjetër... Dhe kështu, pasi morën dhe dhanë ç'patën ushqyer për njëri-tjetrin, gatiten për... Prapë dreq! Këtu heshta. S'mund të vendosja fjalën që më erdhi e para ndër mend. Se nuk shkonte ajo fjalë. Jo. Duhet të gjej një tjetër. Një tjetër, një tjetër, një tjetër, - ndërkohë rrihja gishtat e dorës së djathtë mbi tavolinë, por një tjetër fjalë s'më vjen, sepse ajo nuk ka asnjë sinonim. Doja të thosha që gatiten për jetën, por më sulmon pyetja: Po kjo që përjetuan, çfarë ishte? Jetë? Ëndërr? Ndoshta! Ndoshta! Ndoshta të dashuruarit janë ndryshe nga ne, ndoshta nuk e shohin jetën si ne e, ndoshta, as ëndrrat nuk i shohin si ne. Ndoshta ëndrrat e tyre janë të realizueshme.

I hoqa sytë prej tyre në kohë. Ai ktheu kokën në çastin kur kamerieri riosh mbuloi gjysmën e majtë të fytyrës sime. Pashë sërish telefonin. Nora po vonohej. Në fakt kishin kaluar veç pesë minuta, por më ishin dukur shumë për shkak të filozofimit tim. Fantazova që në minutën e gjashtë njëri prej tyre të më shpjegonte vetëm dyshimin, se pse ata nuk e kishin bërë njëri-tjetrin përparësinë e jetës së tyre. Do të doja ta nxirrja shijen e hidhur të përgjigjes së hamendësuar, ndaj e mbylla pezullin tim me fjalinë që justifikon dorëzimin: Ca gjëra duhet të mbeten mister.

Lojë lufte

Ishte hera e dytë atë javë që tromaksesha ashtu. E para, kishte ndodhur natën e fillimit të javës. Megjithëse e kisha dëgjuar mamin të thoshte se, flitej që së shpejti do të fillonte zbori i grave të kooperativës dhe i linte porositë babit se si të kujdesej për fëmijët, sidomos për dhënien e mëngjesit e dërgimin në shkollë, mendja ime e vogël nuk e kishte rrokur fare peshën e atyre fjalëve. Mbase edhe ngaqë mami i thoshte me zë fare të qetë, ose mbase ngaqë ajo nuk dha ndonjë datë të caktuar për këtë. E dija se shumë gjëra mbaheshin sekret nga të mëdhenjtë e fshatit, siç i quanim atëkohë drejtuesit e partisë e të administratës shtetërore, ndaj dhe fjeta e qetë. Në mesnatë ndodhi llahtaria. Ca tinguj të panjohur më zgjuan tmerrshëm. Nuk po dalloja dot në isha në ëndërr apo zgjuar. Ndieja trupin që më ziente i gjithi dhe goditje të forta në kraharor që nuk më linin të merrja frymë.

- Mami! Mami! Çfarë është kjo? - klitha duke u ngritur vrik mbi jorgan e duke kërkuar më kot në errësirë.

Ajo më trembi më shumë me të zezën e saj, ndaj ngriva në vend. Binjakët u zgjuan e filluan të qanin me lebeti. Gjithmonë linim ndezur dritën e kuzhinës që ne fëmijët të orientohehim për në banjë. Fikej vetëm kur iknin dritat nga stuhitë. Përgjova me ankth jashtë. Nuk frynte, as binte shi, as vetëtinte, as bubullinte. Mund të ishte flohtë se, siç thoshin të gjithë, akoma s’kishin kaluar të ashtuquajturat ditët e plakave, por qielli ishte plot yje. Të paktën, kështu e kisha lënë para se të flija.

- S’është gjë, mos u trembni, - pëshpëriti mami.

Nuk e di si mbërriiti aq shpejt e sesi e gjeti aq lehtë krevatin e binjakëve. Sikur të mos dëgjoja zërin e ëmbël të mamit, që fliste vazhdimisht, edhe pse më e rritur se binjakët, isha gati të lemerisesha bashkë me ta në errësirën e natës e të shtëpisë. Megjithatë sytë m’u lagën. Nuk shikoja asgjë. Teksa gjithçka jashtë ulërinte, u kapa fort pas zërit të qetë dhe shshsh-së monotone të mamit. U ngroha edhe pak, kur babi hyri në dhomën tonë me një llambushkë aq të vjetër të cilën, sipas tij, e kishte blerë stërgjyshi në Stamboll. Hijet e çoroditura shkarravisnin muret që mua më dukeshin sikur lëviznin.

- Mos e ngri shumë flakën, se na shohin, - gati i pëshpëriti mami babit, i cili reagoi menjëherë dhe seç lëvizi në njërën anë të llambës e flaka u ul. U ul edhe drita, u ulën edhe hijet. Babi e vendosi llambën përdhe, pranë tavolinës dhe atëherë edhe hijet, edhe muret u qetësuan.

- Ejani, se do flini me babin, - tha ajo duke marrë në krahë njërin nga vëllezërit, nuk e dallova dot cilin. Ai u mbërthye fort pas qafës dhe mesit së saj dhe vazhdoi të ngashërehej,

pavarësisht fjalëve e puthjeve të saj si e ku mundte mbi trupin e tij. Pastaj mami mori llambën në njërën dorë dhe e ngriti sa më lart që mundi. Shtëpia u ndriçua paksa.

- Merr Sonin, - i tha babit ngadalë dhe, duke u kthyer nga unë, shtoi qetë:

- Rina, kape babin nga dora se mos vritesh, zemër.

Brofa dhe mbërtheva dorën e lirë të babit. Ajo ishte fryma ime atë natë tmerri.

- Çfarë janë këto, ba? - pyeta duke ecur ngadalë ngjeshur pas këmbës të tij.

- Çangat dhe sirenat e alarmit, zemër. Filloi zbori. Të kujtohet që na e përsëriti mami para se të flinim? - foli ëmbël edhe ai, ndërsa puthte Sonin, që ngashërehej mbi supin e tij.

Po, më kujtohej, por nuk më kujtohej asnjë rast më parë, kur mami e babi kishin shkuar në zbor që të kisha dëgjuar këta tinguj e këto zhurma. U rrëqetha. Mos kishte ardhur armiku i vërtetë? Ah, sa i keq ishte armiku! Mos na kishte zënë në gjumë? E dija mirë. Ai vetë nuk flinte. Pse kot e kishte shkruar xhaxhi Ismeti atë parullën mbi murin e dyqanit të ushqimeve: Armiku i brendshëm dhe i jashtëm punon ditë e natë kundër nesh. Nuk i ndaja dot kush ishte i brendshëm e kush i jashtëm, por ja, paskan punuar edhe natën, - mendova e tmerruar dhe i shtrëngova dorën babit. Nga libri i historisë më kujtoheshin vetëm tre armiqtë: turqit, italianët dhe gjermanët. Cili prej tyre kishte ardhur? Mbase turqit me shpata, se shpatat e thikat janë armë të vogla. Me siguri i kanë fshehur në trup dhe kështu rojat tona nuk i kanë diktuar dot.

Çangat vazhdonin ding-dongun e tyre të çakorduar. Çdo lagje kishte çangën e saj. Çanga e lagjes sonë rrinte varur mbi një krah të trashë ulliri përpara zyrës së brigadës ku punonin prindërit e mi. Ishte një copë hekuri a çeliku e shtrembër e këputur s'dihet se ku. Ne fëmijët pak më të rritur kishim pasur një herë fatin ta qëllonim me një zall të zi që na e dha me radhë roja i zyrave. Nën trokitjet tona të frikura apo të gëzuara çanga lëshoi tinguj të kristaltë dhe ne të gjithë, buzëqeshëm me ta. Edhe roja e qëllloi ca herë lehtë duke e lëvizur dorën nëpër gjithë trupin e çangës. Vura re se tingujt ndryshonin. Dukej sikur ai donte të krijonte ndonjë melodi që e kishte në mendje, por unë kaq kuptova. Më vonë mësova se nuk dihej asnjëherë se cila çangë fillonte e para, se, siç thashë, gjithçka mbahej sekret, por ç'rëndësi kishte: brenda një minute ato klithnin të gjitha. E mes çakordimit të tyre futeshin me një ndërprerje disasekondëshe kuisjet e tmerrshme të sirenave. Vetëm në fshatin tonë ishin dy sirena alarmi. I kisha parë nga larg disa herë të dyja. Ruheshin me roja me armë. Ne nuk u flisnim rojave. As ata neve. Njëra çangë ishte te pika e grumbullimit të zboristëve, në qendër të fshatit dhe tjetra ishte në hyrje të repartit ushtarak. Kjo ishte më e madhe dhe më e bukur. Thoshin se kjo e dyta vihej me raste në punë, atëherë kur ishte diçka serioze.

- Po bien të dyja, - mezi dëgjova pëshpërimën e mamit duke na rregulluar mbulesat.

- Ja, e shikoni? Edhe mami është trembur. Mos vallë frika ime ishte e drejtë? Më ngriu fytyra.

- S'ka gjë, - e qetësoi babi, - bien të dyja ngaqë është

gjithë kooperativa për zbor. Kjo e ushtrisë është më e fuqishme dhe njofton edhe fshatrat e tjera.

Ndjeva se fytyra më shkriu. Që nga ai çast babin e desha përgjithmonë shumë. Sipas meje, në një farë mënyre, atë natë ai kishte larguar armiqtë.

- Nisu tani, - i tha mamit, - se mos mbetesh vetëm.

Ishte çasti i parë kur pashë dritaren. Ajo më lidhte me botën e llahtaritur të mesnatës. Zhurmave të çangave e të sirenave u ishin shtuar edhe lehjet e egërsuara e të rrëmujshme të qenve të lidhur e të zgjidhur, që ndiqnin nga pas me këmbëngulje gratë e vajzat e rritura të lagjes. Pas pak iu bashkuan edhe thirrjet që gratë i bënë njëra-tjetrës, bërtitjet për të nxituar se po kalonin minutat që kishin në dispozicion pas alarmit. Nuk e dija që vlerësimi me yje e me fleta nderi niste që me shpejtësinë me të cilën plotësohej skuadra.

- Ik, pa merak, - e siguroi babi, ndërsa mami duke ndalur hapat te dera i përsëriste të njëjtat gjëra.

Teta Shqiponja, e cila në verë kishte ndërtuar shtëpinë ngjitur me tonën, thirri me zë të fortë kërcënues dhe mami doli. E mori errësira. U ndjeva e mjerë. Shtrëngova duart poshtë jorganit dhe u përloja. Babi nuk më pa. Më duhej të bëhesha e fortë. Për mamin. Për babin. Dhe për më të vegjlit. U ktheva nga ata. Binjakët nuk i fshehën lotët. Ndikuan njëri-tjetrin dhe filluan sërish të qanin mbyturazi, duke u kapur fort pas babit. Ai i zhyti ngrohtë në gjoks e i rrethoi me njëren dorë, ndërsa dorën

tjetër ma shtriu mua e më buzëqeshi. Sërish u kapa pas saj. Jetova sërish. Që nga ai çast unë gjithmonë kam ndier nevojën të kapem pas një dore.

Ishim strukur aq shumë pas babit, saqë gjysma e krevatit ishte bosh. Babi na shpjegoi se kjo ishte një detyrë ndaj atdheut, se nuk do të ndodhte asgjë e keqe e se mami në mëngjes, ose e shumta në drekë, do të kthehej sërish.

- Ba, pse nuk e ndezim dritën? - e pyeta me frikë se si do më dilte zëri. - Jashtë nuk po bie shi, - shtova për siguri.

- I kanë prerë, zemër, për ta bërë më të vërtetë situatën e alarmit. Edhe llambat duhen ulur. Se në luftë nuk ka drita. Pastaj me drita armiku të gjen menjëherë, - sqaroi ngadalë, duke i theksuar fjalët. Mua m'u duk se më shumë po u tregonte një përrallë Sonit e Erit që e lanë të qarët dhe po shihnin të përqendruar buzët e tij. Nuk doja t'i trembja sërish. Edhe vetë doja të isha e qetë fare, ndaj ngadalë e pyeta babin:

- Ba, do bëhet luftë e vërtetë apo lojë lufte?

- Lojë, zemër, lojë. Si gjithmonë. Ti je më e rritur dhe e di që edhe mami, edhe unë kemi shkuar disa herë të tjera në zbor. Por ndonjëherë të mëdhenjtë vendosin ta bëjnë si me të vërtetë.

Po, e dija, por pse herët e tjera nuk isha trembur, madje nuk isha trembur as gjithë ato herë kur roja i binte çangës kur fillonte shiu dhe punëtorët vraponin ngaqë i kishin prodhimet e brigadës jashtë?

- Ndonjëherë të mëdhenjtë vendosin ta bëjnë si me të vërtetë dhe ndezin edhe sirenat, - shtoi babi duke më

hequr një dyshim të madh. “Paskan qenë sirenat ato që më lemerisën!”, mendova.

- Kur do të vijë mami? - pyeti Eri zëulët pa lëvizur as dorën nga qafa e babit.

Babi u përkul, u zgjat, puthi Sonin, u zgjat edhe pak e më puthi edhe mua dhe tha gati duke qeshur:

- Po ju thashë, nesër në mëngjes ose në drekë mamin e kemi këtu. Mos u trembni fare. Kur të rriteni, edhe ju do të shkoni në zbor, - dhe babi na përkëdheli të treve.

- Pse? - pyeti Soni aq qetë, saqë mua m'u duk se fjala i doli pa e lejuar ai.

- Po që të stërviteni, të bëheni trima e të mbronit atdheun, - buzëqeshi babi.

- Kush është atdheu? - pyeti Eri pa i hequr sytë nga babi.

Babi pa nga unë. Këtë radhë buzëqeshëm të dy. Binjakët ishin në klasën e parë, kurse unë në klasën e katërt. Unë e dija se çfarë ishte atdheu.

- Atdheu është shtëpia jonë, - iu përgjigja shpejt dhe babi vazhdoi të buzëqeshte. Binjakët sikur u qetësuan pak, por Soni, befas, si ai nxënësi që gjen i pari zgjidhjen e një ushtrimi të vështirë, tha me një zë ku përzihej gëzimi dhe pak pasiguria:

- Po shtëpinë tonë e mbron mami!

- E po, kur të rriteni ju, mami do të plakët dhe plakat nuk i marrin në zbor, - sqaroi duke qeshur me zë të lartë babi. - Pastaj, kur të plakeni ju, shtëpinë do ta ruajnë fëmijët tuaj e kështu me radhë.

- Pse, aq shumë rrojnë armiqtë, ba? - këtë radhë çudia ishte e imja.

- Nuk i dihet, Rinush, sidoqoftë më mirë të jemi gati.

I dhashë të drejtë. Përderisa, sipas parullës që ju thashë, armiku punonte ditë e natë, mirë do të ishte që të ishim gati.

Pas pak të vegjlit, strukur në gjoksin e tij, i zuri gjumi.

- Fli edhe ti, zemër, - pëshpëriti duke lëvizur dorën që, me sa dukej, vetëm unë ia shtrëngoja tashmë. Tunda kokën mohueshëm dhe nuk e lëshova. Nuk guxova të shihja më nga dritarja. Andej vinte më shumë errësirë. Më mirë të shihja gjysmerrësirën brenda. Më mori ca kohë njëjtësimi i mobilieve të dhomës me hijet e tyre mbi tavan apo mbi mure. Pastaj edhe ca kohë me llogaritje nëse kishte mbërritur mami dhe për këtë më orientonin heshtja e sirenave dhe goditjet gjithnjë e më të lodhura të çangave, pastaj përgjimi i shuarjes së lehjeve të qenve më mori më shumë kohë, pasi përpiquesha ta dalloja nga zëri, se cili nga qentë e lagjes po mbahej akoma, e cili e kishte lënë me aq. Qeni ynë vazhdonte, por nuk i thashë gjë babit. Me siguri edhe ai ia njihte të lehurën.

Më në fund, heshtën edhe qentë. Heshti gjithçka. Përfytyrova kupën e qiellit të gërvishtur nga tingujt therës të sirenave. Ndoshta dhe ndonjë yll mund të kishte plasur nga ato kuisje.

Ndonjë mbrëmje në qiellin mbi fshatin tonë vijëzohej një drejtëz e kuqe, që sa vinte e zbardhej nga fundi duke marrë formën e një rruge me borë. Të rriturit mendonin se mund të ishte një avion i ushtrisë që parashikonte motin.

Dyshoja pak për këtë, se ai nuk kalonte çdo mbrëmje, ndërkohë që parashikimin e motit e dëgjonim çdo mëngjes nga ata që kishin parë televizor një natë më parë te mësues Behari, që e kishte blerë për Vitin e Ri ose teta Vjollca ia tregonte mamit në punë. Vite më vonë, kur Genti i lagjes sonë u bë pilot, ne jo vetëm që u ndjemë shumë krenarë për të, por mësuar edhe të vërtetën: rruga e borës ishte thjesht tymi i avionit të një linjeje të huaj fluturimi. Sikur ta kisha ditur atë natë këtë gjë, do të kisha vdekur nga frika. Se mendojeni vetë: të lejohen avionët e huaj në qiellin tënd, kjo nënkupton që ata jo vetëm të bëjnë pis qiellin si të duan, por edhe të spiunojnë e njoftojnë armiqtë. Dhe frika ime atë natë do të ishte më se e drejtë. Edhe turqit me shpata mund të kishin avionë.

Por atë natë s'di pse isha e bindur se, të paktën, dingdongu i çangave nuk e mbërrinte dot qiellin. Ndoshta, ngaqë atë e godiste dora e rojës së brigadës dhe, sado ta kenë ndihmuar të tjerët, prapë dikur do të lodheshin. Çanga mund të tmerronte njerëzit, por jo qiellin.

Sa doja t'i dija ca gjëra, si për shembull, se ku ishte mami, a kishte mbërritur në kohë, a kishin marrë yll, a do të vinin dritat më vonë, por nuk përfytyroja dot më shumë! Analiza ime historike-gjeografike-patriotike-njerëzore e frikësore përbëhej nga fjali të shkurtra që tregonin për mendime të vogla, që edhe këto ngatërroheshin, gjysmoheshin, përpëliteshin nën një lodhje këputëse, të qetë, çlodhëse dhe...

Të nesërmen u zgjova nga zëri i ngrohtë i babit. Sa e doja babin edhe në mëngjes! Vinte erë e mirë. Kuptova se kisha fjetur. S’dihet se kur! Radio “Mimoza” nuk këndonte si çdo mëngjes, kur kishte drita. Nuk e dija se cili ngrihej i pari në mëngjes mami apo babi, por një herë gjyshja më pati thënë se kjo ndodhte sipas punës që kishin atë ditë. Dija vetëm që o njëri, o tjetri ndizte radion. Mami thoshte se e kishte bërë këtë që kur shkonte në shkollë të mesme e ngrihej herët që ndihmonte gjyshen me punët e mëngjesit, kurse babi e kishte zakon nga ushtria, se kishte qenë radist. Babi kishte edhe një gjë tjetër nga ushtria: në muskulin e krahut të majtë shtrihej një piramidë e vizatuar me laps ngjyrë jeshile. Atëkohë nuk e dija pse ai vizatim nuk i fshihej, edhe kur lahej shumë herë. Babin i shkëlqenin sytë kur tregonte për ushtrinë dhe herë-herë rregullonte ndonjë radio që i binte në dorë. Kur babi u martua e doli në shtëpi më vete, gjyshi i kishte dhënë ca lekë për t’u rregulluar, si për fillimin e jetës, por babi kishte blerë radion. Gjyshi nuk ishte mërzitur, por vetëm kishte psherëtirë: Eh, mor bir!.

M’u desh vetëm një puthje e babit që të qartësohesha.

- Ka ardhur mami? - pyeta duke u ngritur vrulltas e duke zbuluar edhe binjakët, që lëvizën njëherësh. U sulëm të tre dhe, me siguri, që do të kishim rënë nga krevati, nëse babi s’do të hapte krahët e të arrinte të na ndalonte në buzë të tij.

- Prisni, se u vratë, - tha ai duke i rezistuar peshës sonë. - Mami nuk ka ardhur akoma, por me siguri do të vijë shumë shpejt. Kur të ktheheni nga shkolla, do ta gjeni në shtëpi.

Ne të tre u zmbrapsëm pak. E ndjeva njëlloj me binjakët dëshpërimin, por ishte ditë, kishte dritë dhe dritarja m'u duk e madhe.

- Bëhuni gati për në shkollë, zemrat e mia, - na përkëdheli të treve kokën dhe shtoi: - Përsheshin me qumësht e keni gati. Rina, ndihmoji vëllezërit që të vishen shpejt.

Vetëm kaq? Vetëm kaq më kërkonte ai njeri që e doja aq shumë? Ai që më mbajti gjallë? Të ndihmoja vëllezërit që të visheshin? Isha gati të bëja gjithçka: punët e shtëpisë, t'u hidhja zogjve, të kullosja lopën, të mblidhja bar, të merrja vetëm dhjeta në shkollë. Putha babin. Nuk di të them nëse ai e kuptoi sa shumë e doja. Fluturova nga krevati dhe fluturova edhe gjithë paraditen. Mendja ime ishte o te mami, o te binjakët që i mbajta përdore deri në shkollë, e që ata nuk kundërshtuan, o te babi që kishte gjithë ato punë. Në fakt, do të kishte qenë gjë e mençur, nëse ata të mëdhenjtë e fshatit do të na kishin lënë pushim atë ditë, se ne ishim shumë të lodhur nga pagjumësia. Ose të paktën kështu i thamë mësuese Elës.

Shumë nxënës i treguan ndjesitë e tyre të kaluara atë natë. Ama asnjëri nuk kishte qarë. Më erdhi turp për përlotjen time. Dukej që isha frikacake, po babi i askujt prej tyre nuk i kishte shpjeguar se çfarë po ndodhte. U kishin thënë shkurt: "Asgjë s'po ndodh, po fli gjumë", dhe ata nuk e dinin se kur do t'u kthehej mami. Kurse unë dija shumë, pothuajse gjithçka që dinte edhe mësuese Ela. Ajo foli jo vetëm për zborin, por edhe për çështjen e mbrojtjes së atdheut edhe nga gratë dhe unë u ndjeva mirë.

- Se gratë tona, - tha ajo me zë të lartë, - që nga mbretëresha Teutë e deri te Shote Galica, janë pjesë e historisë kombëtare.

Sipas llogarive të mia, me sjelljen time, përveç asaj përlojtjes që s'ma pa njeri, kisha ndihmuar prindërit në kryerjen me sukses të detyrës së rëndësishme të mbrojtjes së atdheut nga armiku. Këtë punën e armikut të brendshëm apo të jashtëm nuk e mora dot vesh akoma, por do të pyesja babin. Ai dinte gjithçka.

Rrugën e kthimit nga shkolla e bëmë në heshtje. A thua se kishim frikë mos dëshira jonë na prishte magjinë që ushqente shpresa e gjetjes së mamit në shtëpi. Ndoshta nga ankthi a ndoshta nga nxitimi këmbët na u rënduan aq shumë, saqë, duke iu afruar shtëpisë, filluan të na çanin muskujt e kërcinjve. Por nuk u ndalëm. Edhe pse frymëmarrja e thatë me gojë të hapur po na mbyste, i thirrëm mamit që te porta. Thua jse të tre njëherësh u ngjeshëm te hapësira e vogël e saj. Të vegjlit u futën shtyrasi dhe vrapuan në oborrin e pastruar. Kaq m'u desh. Mami kishte ardhur. Ndalova në vend. Shtëpia, kopshti, lulet, gjithçka tashmë ishte e bukur. Frika, lodhja, tmerri, malli dhe çlirimi u bënë njësh dhe u përloa sërish. Prita sa mami u çmall e qetësoi binjakët. Pastaj u nis drejt meje me buzëqeshje të dukshme. Binjakët e ndoqën nga pas duke e kapur nga të dyja këmbët. I pashë të më buzëqeshnin me krenari. Mbase në mendjen e tyre të vogël ata besonin se ishin ata, të cilët e gjetën mamin. Rrufita hundët fort dhe u buzëqesha. Nuk doja t'i trembja

sërish, ndaj, duke bërë sikur rregullova balluket, fshiva shkarazi sytë. Mami hapi krahët. U sula mes tyre. Mbylla sytë ende të lagësht dhe nuhata. Edhe mami vinte erë e mirë. E vetmja gjë që i kërkonte teze Merit nga qyteti ishin sapunët me aromë. Në fillim mami na sapuniste të tria herët me sapunët e saposjellë nga teza, pastaj, kur e shihte që po mbaronin, na fërkonte dy herë me sapun rrobash dhe herën e tretë me sapun qyteti, - siç i quanin ne. Kështu, sipas saj, sërish do të vinim erë e mirë. Një herë sapunët mbaruan fare dhe teza u betua për kokën e Artës që nuk po gjente askund as për vete.

- Po ta kisha qoftë edhe një, - i deklaroi ajo mamit, që e shihte dëshpërueshëm në sy, - do ta ndaja me ty. Më beso, është tharë fare, është bërë na, - dhe teza goditi prerë kurrizin e dorës. - Na morën më qafë, - tha mami me zë të ulët duke parë anash.

Të nesërmen mami shkoi te nëna, por nuk u vonua. Erdhi me një tufë borziloku gjethegjërë dhe e vuri të ziejë. Që nga ajo ditë mami nuk u tremb më për sapunët. Kur teza nuk gjente dot, ajo ziente o borzilok, o petale trëndafili, o rozmarinë, o trëndelinë, ose çdo lule tjetër që gjente. Fundja ne oborrin e kishim aq plot me lule të bukura, saqë të gjithë djemtë që martoheshin në lagje vinin te ne për buqetën e luleve të nuses. Babi sajonte buqeta të bukura. Mundim hiqte të gjente qese, për të mbështjellë kërcejtë e luleve.

- Nuset e bukura gjembat mos i prekshin! - uronte teksa duke buzëqeshur i zgjaste tufën e luleve fëmijës, i cili ose

e cila, sipas traditës, ishte caktuar t'i jepte nuses tufën e luleve që kur ishte prerë dita e dasmës, më e pakta gjashtë muaj më parë.

Pas zbulimit të sekretit të ujit të luleve, shpëlarjen e fundit të flokëve dhe trupit mami tashmë na e bënte gjithnjë me ujin e luleve. Për vete ajo gjithmonë shtonte në gjoks gjethe ose petale lulesh. Më pëlqente shumë që mami vinte erë e mirë dhe fshehurazi kisha krijuar edhe një vjershë për të, rima e së cilës më dukej shpikja më e madhe: “Kush është më e mira? Mami Mira erëmira”. Kur ia thashë teze Merit, ajo qeshi deri në përlotje, më puthi fort e fort, siç bëjnë të rriturit kur kënaqen shumë, më mori në krahë dhe më çoi para mamit e babit duke u thënë:

- Ja ku e keni poeten e fisit.

Unë thashë vargjet, puthjet u dyfishuan, babi e mami shkëmbyen shikim të fshehtë. Nuk e shqova dot në ishte mes tyre, apo ishte për mua.

U futëm në shtëpi. Lashë çantën mbi krevat, vuajta pak të hiqja xhakaventon e ngushtë të Artës që më pati dhënë para dy vjetësh tezja dhe ndihmova binjakët të zgjidhnin lidhëset e këpucëve të reja. Kisha qenë edhe unë me babin në dyqan, kur ua blemë. Teta Resmia, shitësja e moshuar që ishte shoqja e ngushtë e gjyshes, ndërsa merrte lekët, u përpoq t'i qante hallin babit:

- I ke dopio harxhimet, Beso, - i tha me pak keqardhje në fytyrë, por edhe me përkëdheli në zë.

- E po, edhe punën për ta dopio e bëra, - iu përgjigj babi duke fshehur pak fytyrën e kënaqur. Teta Resmia ia plasi të qeshurës dhe tundi gishtin tregues me ledhatim sikur t'i thoshte: “A, qerrata, qerrata!”, dhe ai e shoqëroi. Vetëm kur u rrita, e kuptova pse qeshnin.

- Sa të vijë babi, ju do të hani nga një petull që ju kishte sjellë nëna në mëngjes, - tha mami duke na vënë një pjatë të ciflosur në mes tavolinës së vogël. - Sa kishit ikur ju në shkollë, kishte ardhur. Kishte pasur merak për ju, por s'e dëgjonte dot orën në radio, se nuk kishte drita, ndaj dhe ishte vonuar. Kur erdha unë, po rregullonte shtëpinë, - shtoi duke na hedhur pak sheqer mbi petulla. I ngula fort dhëmbët në petull. Ca kokrriza sheqeri m'u shkrinë në gojë, ca m'u ngjitën mbi buzën e sipërme e ca m'u rrokullisën mbi kraharor. Nuk lëviza as gishtin. Qenia ime ishte plot me ëmbëlsirë dhe me qetësi. Si për ta shijuar edhe më fort pezullin e lumturisë, i ngula sytë drejt murit. Ishte i bardhë. Nuk dridhej asnjë hije. E kisha mundur frikën dhe natën.

- Ma, mbaroi zbori? - e pyeta pasi kisha ngrënë gjysmën e petullës.

- Jo, zemër, e kemi të plotë këtë radhë, një javë, - tha qetë ajo.

Kur mami fliste qetë, unë s'kisha frikë fare.

- Do ikësh prapë natën? - pyeti Soni duke e ngrirë petullën para gojës.

- Jo, - tha sërish qetë ajo, - kemi orar 8 me 12. Vetëm ditën e qitjes mund të vonohemi, - sqaroi duke na parë në sy.

- Çfarë është qitja? - pyeta unë e befasuar nga kjo fjalë e re për veshët e mi.

- Ta shpjegon babi pastaj, - tha duke dalë ajo. Nxitonte. Teta Monda, fqinja tjetër, po e thërriste. Zakonisht kërkonte ndihmën e mamit për të kthyer zogjtë e vegjël që futeshin në oborrin tonë përmes vrimave aq të vogla të gardhit me tela që kishte sajuar babi. Kur babi e lidhi rrjetën, xhaxhi Petriti e ironizoi një çikë kur i tha:

- Duket që e bërë ushtrinë në kufi. E rrethove me klon edhe shtëpinë.

- Edhe shtëpia atdhe është, - i kishte thënë babi dhe kishte parë nga unë. - Pastaj, piramidën në krah e ke edhe ti.

E kisha parë edhe unë këtë. Të dy kishin piramidë në krah. Sipër piramidës së babit lexohej: Vermosh. Brenda saj me shkronja të mëdha lexohej: RPSSH, kurse poshtë saj: '79-'81. Ndërsa krahun e xhaxhi Petritit nuk e kisha lexuar dot.

Porta e drurit rënkoi dhe ne e morëm me mend se ishte babi. Brofa dhe këtë radhë nuk i lashë binjakët të ma kalonin. Babi pati kohë sa për të lënë lopatën dhe më përfshiu në krahët e hapur. Pas meje u ngjeshën binjakët. U bëmë grumbull dhe ndenjëm ca në një lloj prehje. Diçka e kishte ndryshuar secilin nga ne.

- Kujdes, se do të rrëzoheni!

Zëri i mamit na përmendi. Ajo u afrua dhe ne u hapëm. Babi bëri veç dy hapa të vegjël dhe e puti në faqe. Edhe pse ata buzëqeshën lehtë, unë ua pashë dritën në fytyrë. Gjyshe Leta gjithmonë gëzonte kur babi e puthte mamin. Ajo dhe gjyshi duheshin shumë, por vetëm gjyshen kisha parë ta puthte. Kur ajo zgjatej drejt tij, ai nuk lëvizte. Ngrinte disa

sekonda me faqen drejt saj, pastaj kapërdihej dhe lëvizte lehtë fare buzët.

- Sa mirë që ngjave nga unë, - i thoshte gjithmonë gjyshja babit, ndërsa e puthte në flokë. Nuk e di pse babi gjithnjë i afronte cepin e ballit: ose të majtin, ose të djathtin.

- Hë, si shkoi? - pyeti babi dhe unë u hutova pak se nuk e kuptova në pyeti mamin apo ne. Për të qenë e sigurt e pashë në fytyrë. Sytë e tij ishin nga mami.

- Mirë, - tha qetë ajo, - si gjithmonë, por më e madhe.

- Kuptoj, - shtoi babi dhe ne ecëm thuajse grumbull drejt derës. Babi u ndal te kova e ujit që mami e linte gjithmonë në cep të ballkonit dhe lau duart. Ne e pritëm të gjithë pastaj hymë në shtëpi.

- Dreka është gati, - njoftoi mami, - nëse do, ulemi.

- Erdhe shpejt? - pyeti babi kureshtar.

- Rreth orës 9. Ama, na griu uria, - dhe mami ndali para bufesë dhe, për të theksuar vuajtjen e saj, e pa babin ngultas sikur po i thoshte një sekret.

- E po, hamë, - tha babi përnjëherësh dhe rregulloi stolat e binjakëve. Ishin dy stola druri të vegjël që babi i kishte porositur te zdrukthëtaria e kooperativës, por xha Qerimi i kishte shënuar vetëm një në faturë. Xha Qerimi ishte i famshëm në kooperativë për tri gjëra: së pari, ishte shumë punëtor dhe dilte gjithmonë i dalluar në brigadën e zdrukthëtarëve dhe merrte çdo vit medalje nderi; së dyti, shihej lirshëm që kishte duar shumë të mëdha, aq sa unë për vete kisha frikë kur e shikoja nga afër; së treti, kulmin

e famës e arriti me atë që i kishte punuar, siç thoshin të gjithë në fshat, një të madhi, Janit, përgjegjësit të sektorit. Tri ditë para Vitit të Ri, xha Qerimi dhe Jani ktheheshin në fshat nga festa që kishte bërë kooperativa për nder të punëtorëve të dalluar. Kuptohet që xha Qerimi kishte marrë medaljen e radhës, e kishte futur kuturu në xhep dhe ishte nisur drejt shtëpisë në heshtje, pavarësisht se binte shi. Askush nuk dinte ta zbërthente heshtjen e tij. Ca thoshin që s'i bënin përshtypje teneqeçkat që merrte, ndaj ua jepte nipërve të luanin me to; ca thoshin se nuk ishte dhe aq në rregull nga trutë; ca që ashtu pus kishte qenë që në vogëli. Jani ishte djalë i ri dhe pak kohë kishte që ishte transferuar si përgjegjës në sektorin tonë. Ecte dhe ai i heshtur përkrah heshtjes së xha Qerimit dhe mendohej me gjithë zemër ta mbante sa më mirë çadrën e re që të përfshinte në të sa më shumë trupin e bëshëm të xha Qerimit. Shiu e bënte rrugën e paasfaltuar të rrëshqitshme, megjithatë Jani mbahej fort. Dikur psherëtiu si me vete:

- Bëra mirë që bleva këtë çadrën, se do të ishim lagur.

Xha Qerimi nuk foli. Ecën dhe ca dhe shiu u bë rrebesh. Këtë radhë Jani foli i kënaqur:

- Sa mirë që mora çadrën me vete!

Xha Qerimi vazhdonte të heshtte. Diku, në gjysmë të rrugës, pasi rrebeshi i dimrit u bë stuhi, Jani foli me zë të plotë:

- Po të mos ishte çadra ime, do të ishim bërë qull tani.

Atëherë xha Qerimi doli nga çadra dhe i ra përmes një

pellgu të madh. Uji i mbërriti deri në gjunjë. Kur doli në anë, u kthye nga Jani që kishte ngrirë gojëhapur me çadër në dorë dhe i tha:

- Do të isha njomur më shumë se kaq pa çadrën tënde?

Dhe iku në shi. Ishte vetë Jani që e tregoi ngjarjen në fshat. Kur e dëgjoi, gjyshi im qeshi dhe duke tundur kokën tha:

- I ri është Jani, do kohë të mësojë se çadra ia ka zënë vendin gunës.

Të vegjlit u rehatuan dhe ne filluam të hanim. Gjithmonë disa kafshata bukë e disa lugë gjellë në fillim hahen në heshtje të plotë. Me sa duket qenia pushtohet nga instinkti bazë.

- Do të kemi një javë zbor, - tha dikur mami që me siguri kishte ngrënë diçka, kur kishte ardhur aq e uritur.

- E mora vesh, - foli babi me vështirësi, pasi po përtypej. Pastaj u kapërdi dhe vazhdoi:

- Të thashë që mbrëmë se është organizim i madh. Më thanë se kanë ardhur oficerë të vërtetë për t'ju stërvitur.

- I pashë, - plotësoi mami. - Pse do të rrinë gjithë javën ata? Se zakonisht vetëm ditën e parë rrinë. Apo ngaqë në fund do të ketë qitje?

- Do të rrinë, - pohoi babi bindshëm. - Pas jush do të ketë ngritje edhe për ne. Dëgjova se do të na çojnë në mal.

- Bobo! - psherëtiu me frikë e bezdi mami dhe atë çast më kapi lemeria. Kur trembeshin ata, unë pataksesha. E kuptova që situata ishte serioze. Kjo qitja që thoshin ata më tromaksi.

- Babi, çfarë është qitja? - pyeta aq ngadalë, saqë pata frikë nga zëri im.

Babi më pa një çast me fytyrë pyetëse dhe unë nuk lëviza as qerpikët. Nuk e kuptova në më qortoi që nuk e dija, apo në u çudit që po pyesja veçanërisht për atë gjë.

- Qitje do të thotë të qëllosh me plumba një tabelë, - sqaroi babi duke treguar me duar gjysmëtrupin e tij të sipërm. - Por jo plumba të vërtetë, - shtoi menjëherë duke më hequr nga goja pyetjen e radhës. - Qitja është e rëndësishme se na stërvit si të qëllojmë me pushkë drejt armikut.

Ishte çasti që kisha pritur që në shkollë, ndaj e pyeta sërish babin:

- Cilit armik? Të brendshëm apo të jashtëm?

Këtë radhë babi më pa më gjatë në sy dhe tundi kokën me një lëvizje të paqartë.

- Ku e ke mësuar këtë? - pyeti me zë neutral, ndërsa mua m'u duk sikur fshehu pak qortim.

- E kam lexuar te parulla që shkroi xhaxhi Ismeti në murin e dyqanit të ushqimeve, - i thashë pa e gënjyer asnjë çikë.

- Nuk e kam vënë re, - tha me zë të ulët duke u parë në sy me mamin.

- Duhet të bëhemi gati, - ndërhyri ajo, - se mund të na bëjnë ndonjë alarm tjetër së shpejti. Këtë radhë do të jetë alarm gazi.

Babi nuk foli dhe unë ngriva me sytë drejt tij. Përderisa nuk foli, do të thotë se ishte gjë e rëndë.

- Nesër do të na japin uniformën dhe armatimin. Edhe kundërgazin, - shtoi mami për saktësi.

- E po, ata e dinë, - foli shkurt ai.

Sërish doja ta pyesja babin se çfarë ishte alarmi i gazit. Vetë babi më erdhi në ndihmë.

- Rina, zemër, me siguri nesër mësuesja do t'ju mësojë se çfarë duhet të bëni që të jeni gati.

- Edhe ne do të vijmë në zbor? - pyeta me sy të shqyer e trup që më dridhej.

- Jo, shpirt, jo në zbor, por, po u dha alarm i përgjithshëm, do të strehohemi të gjithë në tunel. Se lëndët kimike janë të rrezikshme edhe për fëmijët, ndaj duhet të mësoni si të veproni, - sqaroi mami duke kërkuar me sy miratimin tim.

Pashë binjakët. Eri kishte mbetur me lugë në dorë, kurse Soni kishte kapur dorën e mami.

Sa shumë fjalë të reja! Pashë se babi nuk kishte shumë dëshirë të m'i shpjegonte, ndaj heshta me frikë. Nganjëherë ky është gabimi i madh i të rriturve: duke menduar se na mbrojnë, na lënë të fantazojmë. Disa fantazi janë vërtet të frikshme.

Pasditja ishte festë. Mami nuk shkoi në punë.

- Ditët e zborit do të na i paguajnë si ditë pune të plota, - tha ajo, kur nëna erdhi ta takonte sërish pasditë. Me nënën ishin edhe fëmijët e xhaxhi Albanit.

- Mirë, të keqen, shtrihu e fli pak se gjithë natën u lemerisët, - e këshilloi ajo me zë të ngrohtë. - E po dhe kjo punë! Gratë natën në zbor! Edhe Vjollcën e vura të flinte dhe erdha të

marr fëmijët. Do dalim tutje nga gjyshi, ta ndihmojmë me lopët, - shtoi duke na përfshirë të gjithëve me sy.

Ne u gëzuam. Gjyshi ynë ishte pensionist dhe na ndihmonte duke ruajtur edhe lopën tonë. Kur shkonim me të, ne mund të hanim shumë fruta. Ndryshe nga gjithë të tjerët, ai nuk kishte frikë fare nga Brahimi, roja i tmerrshëm i pemëtores.

- Është yt atë, pa je ti, - kështu e përshëndeste gjithnjë gjyshi dhe çuditërisht Brahimi i frikshëm qeshte. Kur u rrita, e mësova arsyen: kur kishin qenë të rinj, gjyshi e kishte shpëtuar dy herë nga mbytja në lumë babain e Brahimit.

Binjakët të gëzuar rendën drejt shapkave të grisura, kurse unë u stepa pak: nuk doja të ndahesha nga mami, por, kur i pashë sytë e zvogëluar nga përgjumja, nuk fola fare dhe ndoqa nga pas binjakët.

Të nesërmen ndodhi siç më paralajmëroi babi. Mësuese Ela tha se edhe ne fëmijët, pleqtë, plakat dhe burrat, me një fjalë të gjithë ata që nuk ishin në zbor, duhej të bënim gati maska kundër gazit. Pritej një alarm i madh. Armiku, sipas mësueses, ishte o rus, o kinez. U çudita shumë! Nuk kisha dëgjuar dhe as lexuar gjë për ta. Mos ishin këta armiqtë e jashtëm? Sa po më mundonte ky dyshim! S'dihej mirë se kush nga ata ishte zemëruar me ne. Me sa ndihej, na e kishte bërë benë.

- Na kanë halë në sy, - shtoi mësuesja dhe mua m'u kujtua një pulë deti që s'dihej sesi iu fut një halë gruri në sy. Të gjithë u munduan t'ia hiqnin, por u vinte si vështirë e si frikë kur provonin t'ia hapnin syrin. Ashtu rroi e gjora deri në Vitin e Ri.

Mësuesja ishte njoftuar që një ditë më parë nga të mëdhenjtë dhe kishte përgatitur maskën e saj. Ishte një katror prej rrobe të bardhë, me dy lidhëse të gjata, por ajo tha se mund ta bënim edhe në ngjyra të tjera.

Mësuese Yllka e binjakëve hyri pa trokitur fare në klasën tonë dhe më porositi që t'u bëja maska edhe atyre. Pranova duke ulur kokën. Qepja ishte tmerri im. Sado që përpiqesha, gjithmonë gjilpëra më ikte shtrembër. Mami mblidhte buzët dhe e mbaronte vetë punën. E vendosa: këtë radhë do t'i thosha nënës. Nuk mund të turpërohesha në shkollë. Ajo do të bënte për të gjithë familjen: për vete, për gjyshin, për xhaxhi Albanin, teta Vjollcën, Borën dhe Florin. Gjithë pasditen mbeta te nëna. Ajo grisi një çarçaf aq dalëboje, sa nuk e dija ç'ngjyrë mund të kishte pasur e që teta Vjollca e përdorte prej vitesh çdo shtator për të mbledhur pambuk në fushën e madhe. Në fakt nëna, maskat e ne pesë fëmijëve, i qepi të parat, por mua më erdhi turp të përfitoja aq shumë, ndaj ndenja me të deri në fund. Vetëm gjyshi nuk e provoi maskën. E vari mbi hekurin e kokës së krevatit dhe foli thatë:

- Kur të vijë ai drejt armiku!

Të nesërmen u ndjeva mirë. Mësuese Elës iu desh t'u bërtiste disa nxënësve, që nuk e kishin marrë seriozisht punën, e që bëheshin aq lehtë pre e armikut të egër - që na do të vdekur, - e mbylli ajo ulërimën e fundit. Nga ulërimat e saj kuptova se çështja duhej të ishte shumë serioze. Edhe babi e kishte përmendur disa herë rëndësinë e këtij zbori.

Fillova të kem frikë sërish, por nuk u përloja. As armiku i brendshëm e as ai i jashtëm nuk do të më shihnin duke qarë. As ata të klasës e as ata të shtëpisë. Nëse, por nëse do të përloresha ndonjëherë, do ta bëja vetëm poshtë jorganit. Mami nuk do të habitej fare se unë shpesh ngatërrohem aq shumë me jorganin, çarçafin apo jastëkun, sa që dy herë, kur kam qenë më e vogël, mami kujtoi se kisha ikur natën nga shtrati.

Hera e dytë e alarmit të zborit ishte më e frikshme. Ndodhi natën, e enjte, ose më saktë, duke u gdhirë e premtë. Edhe pse e prisnim, sërish gjithçka u përsërit njëjtësisht. Çangat dhe sirenat shpërthyen njëherësh. Sërish binjakët ia plasën të qarës me zë. Edhe pse doja t'i qetësoja, u hallakata shumë që të zgjohesha e të kuptoja se ku isha e ç'po ndodhte. Isha e sigurt se këtë herë nuk do të trembesha, por ishte një zë i fortë burri që mbushte qiellin dhe ajrin e fshatit, i cili më hutoi fare.

- Gazi! Gazi! Gazi!

Zëri ishte i qartë, i prerë, urdhërues. Sërish hijet e llambës së famshme të stërgjyshit tim pushtuan dhomën.

- Ba, pse këtë herë bërtet edhe ky burri? - pyeta duke dalë nga jorgani.

- S'është gjë zemër, mos u tremb. Po lexon një parullë, që na tregon llojin e armëve që po përdor armiku, që të bëhemi gati.

- Rina, na, zemër, vishi, - dhe mami më hodhi mbi prehër tutat e reja. E kuptova, por pyeta për siguri.

- Do vemi edhe ne në zbor, ba?

- Po, zemër, të gjithë, siç ju ka thënë mësuesja.

-Vishi mirë, fëmijët se është ftohtë jashtë, - tha ai duke zgjatur krahun me llambën drejt mami të kanata e dollapit e hapur plotësisht. Mami trazonte, kërkonte, nxirrte, fuste, hidhte rroba mbi krevatin tim që ishte më afër. Shumë syresh ranë përdhe. U zvarrita disi nën dritën lëkundëse të llambës së famshme të stërgjyshit dhe i hodha mbi të tjerat në krevatin tim.

- Ti je gati? - pyeti mami babin, ndërkohë që me të dyja duart u fshinte sytë e faqet e qullura binjakëve që nuk bëzanin më.

- Nuk vonohem, - tha babi dhe la llambën mbi parvazin e dritares. Për herë të parë pashë jashtë. Llamba reflektohej në xham dhe drita e saj copëtohej në qindra rreze sipas vrimave të kortinkave prej bize që mami i kishte sjellë në pajë. Errësira me çanga, sirena, zë burri e lehje qensh që ndërsenin njëri-tjetrin, nisi të mbushej edhe me zërat e njerëzve që i thërrisnin njëri-tjetrit.

- Shpejt!

M'u duk se babit, që hyri në dhomë i veshur me xhup, i shpëtoi fjala se e pashë që u pendua. Mami po bënte çmos.

- Gati! - thuajse psherëtiu mami. Binjakët e pagojë kapën njëri-tjetrin për dore dhe pas tyre edhe unë kapa babin nga cepi i xhupit.

- Po i lë kështu, - tha mami duke treguar me dorë të lodhur rrëmujën. Tërhoqi një pallto me kuadrate gri e të zeza dhe u nis për të dalë.

- Jemi vonë? - pyeti duke mbledhur flokët brenda kapelës me yll të kuq e me një fjongo po të kuqe pas kokës. Atëherë e pashë se ishte veshur me uniformën e zborit. Mamit i shkonte kapela. E rinonte. Mami ishte e bukur, por shamia kolektive e bardhë me qëndisma e rruaza anash e treste me të gjitha gratë e tjera. E kishte larë uniformën e zborit menjëherë sa e kishte sjellë në shtëpi, i kishte qepur me kujdes një rrip bezeje të bardhë te jaka dhe e kishte hekurosur me hekur të ngrohur mbi sobë. Hekurin e ri ajo e përdorte vetëm për “rrobat për mik”, - na sqaronte gjithmonë dhe ne e dinim me saktësi, në çdo kohë, se cilat rroba kishim për të shkuar mik. Kurse hekurin tonë të vjetër, i cili rronte ende vetëm për meritë të kujdesit të babit, e përdorte edhe e gjithë lagjja. Ne ishim krenarë që kishim dy hekura.

- S’ka gjë, - tha babi duke ecur pas saj bashkë me ne të tre, - kemi më shumë kohë për t’u paraqitur, se jemi me fëmijë.

U qetësova pak. Të paktën ne fëmijëve na e falkan pak vonesën. Ndryshe ndodh në shkollë.

- Maskat! Harruam kryesoret! - gati klithi mami dhe u kthye vrulltas. Ne mbajtëm këmbët të katërt. Të paktën i kishim vënë në një vend të sigurt. - Mbi bufe, që të mos i harrojmë, - kishte thënë mami të mërkurën, kur i rregulloi përfundimisht.

Mami na i lidhi maskat shpejt e shpejt. Ndjeva erën e trëndelinës. Mos vallë nëna i kishte thënë teta Vjollcës që t’i lanin edhe rrobat me ujë lulesh? Por u kujtova që nëna u fuste rrobave trëndelinë të thatë.